



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SEKTORI I KOORDINIMIT NDËRKOMBËTAR PROJEKTEVE DHE KËRKIMIT
SHKENCOR



Finanziato
dall'Unione europea
NextGenerationEU



Ministero
dell'Università
e della Ricerca



Italiadomani
Piano Nazionale
di Ricerca e Innovazione



Università
del Molise

Nr. 723 Prot.

Gjirokastër, më 25.04.2025

Lënda: Thirrje për aplikime për bursë mobiliteti për studim për studentët e programit të studimit Bachelor në "Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm" në kuadër të Programit Erasmus +.

Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër në bashkëpunim me Universitetin e Molises, Itali, në kuadër të Programit Erasmus+ për komponentin KA1, fton të gjithë studentët e programit të përbashkët të studimit Bachelor në "Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm", të aplikojnë për bursë mobiliteti për studim.

Mobiliteti përfshin:

- Shkëmbimin për studentët e programit të përbashkët të studimit Bachelor në "Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm".
- Kohëzgjatja: 5 muaj
- Numri i kuotave: 4
- Periudha e mobilitetit: Semestri i vjeshtës së vitit akademik 2025-2026
- Bursa: 850 Euro/muaj
- Shpenzime udhëtimi: 180 Euro në total

Kriteret e përzgjedhjes:

Studentët do të përzgjidhen në bazë të skemës së miratuar në rregulloren "Për Implementimin e Marrëveshjeve Ndërinstitucionale në Kuadër të Programit "Erasmus+" KA107 International Credit Mobility", sipas kriterëve të mëposhtme:

- merita akademike,
- kompetenca gjuhësore (Njohja e gjuhës angleze minimalisht në nivelin B1/ Njohja e gjuhës italiane minimalisht në nivelin B1).

Në rast të kandidatëve me pikë të barabarta:

- Prioritet do tu jepet studentëve që u përkasin grupeve me diversitete sociale ekonomike, gjinore, racore, ngjyre, aftësi të veçanta, etj.
- Barazia gjinore (aty ku është e mundur, të përzgjidhen kandidatë të barabartë në numër për nga gjinia).

- Prioritet do t'u jepet studentëve që nuk kanë përfituar më parë nga programi Erasmus+ KA1.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Letër motivimi në anglisht
- Kopje e dokumentit identifikues (pasaportë)
- Vërtetim studenti
- Listë notash
- Çertifikatë që vërteton njohjen e gjuhës së huaj.
- Dokument që vërteton që studenti u përket grupeve me diversitete sociale ekonomike, gjinore, racore, ngjyre, aftësi të veçanta, nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike ose bursë nga shteti etj, (nëse e dispononi)

Dorëzimi i dokumentave të aplikimit kryhet në një nga mënyrat e mëposhtme:

- Elektronikisht (të skanuara në formatin pdf) në adresën: iro@uogj.edu.al
- Dorazi pranë Sektorit të Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor

Afati i fundit i aplikimit është 09/05/2025.

Procedura e përzgjedhjes:

- UGJ ngre një komision *ad-hoc*, i cili do të vlerësojë dokumentacionin e dorëzuar.
- Kandidatët fitues do të njoftohen në adresën e tyre elektronike.
- Kandidatët aplikues kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit të komisionit *ad-hoc* pranë Rektorit brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit.
- Në përfundim të afatit të ankimit, SKNPKSH përcjell listën e studentëve të nominuar pranë universitetit pritës.
- Studentët e përzgjedhur do të kontaktohen prej universitetit pritës për të vazhduar më tej me procedurat e nevojshme.

Për më shumë informacion rreth mobilitetit dhe mënyrës së aplikimit mund të kontaktoni me:

- Sektorin e Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor (iro@uogj.edu.al).

Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë ju uron suksese!

Zv/Rektore për Koordinimin Ndërkombëtar dhe Kërkimin Shkencor

Prof. asoc. Merita Isaraj




Konceptoi: Irma Gjollëshi

